



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr. _____, Datë _____.____.2016

**PËR
DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9918, DATË 19.5.2008 “PËR KOMUNIKIMET
ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 55, pas shkronjës “b” të pikës 2, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) shërbimet e roaming-ut mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara për zbatim me interes reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime.”

Neni 2

Në nenin 89, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun janë të detyruar të ofrojnë pa pagesë thirrjet drejt numrave të emergjencës.”

2. Shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“ 3. Sipërmarrësi i ofron pa pagesë, autoritetit përgjegjës për pritjen dhe administrimin e thirrjeve të emergjencës, përfshirë dhe ato drejt numrit 112, informacion për numrin thirrës dhe vendndodhjen e tij, sapo kryhet një thirrje drejt numrit të emergjencave.”

Neni 3

Në nenin 101 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i nenit 101, ndryshon me këtë përmbajtje:

“Ruajtja dhe administrimi i të dhënave për qëllime të ndjekjes penale, ruajtjes së sigurisë publike dhe kombëtare”.

2. Pika 6 e nenit 101, ndryshon me këtë përmbajtje:

“6. Të dhënat që ruhen në këta skedarë duhet t’u vihen në dispozicion Gjykatës, Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore, sipas kërkesës së tyre edhe në formë elektronike, brenda 7 ditëve nga paraqitja e kërkesës sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Penale”.

3. Pas pikës 6, shtohen pikat 7, 8, 9, dhe 10 me këtë përmbajtje:

“7. Përveç sa parashikohet në pikën 6, të dhënat për:

i) identifikimin e pajtimtarit kur dihet numri apo adresa e IP;

ii) identifikimin e pajisjeve apo adresave të IP për një pajtimtar të dhënë;

iii) identifikimin e vendndodhjes së një pajisje fundore apo IP;

iu vihen në dispozicion autoriteteve të përcaktuara në pikën 6, sa më parë, por në çdo rast jo më vonë se 24 orë nga paraqitja e kërkesës.

8. Për nevoja të ruajtjes së sigurisë publike dhe kombëtare, parandalimit të krimeve të rënda dhe akteve terroriste, të dhënat e përcaktuara në pikën 7, iu vihen në dispozicion nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, Shërbimeve Informative dhe të Inteligjencës, Policisë së Shtetit dhe Policisë Ushtarake, jo më vonë se 24 orë nga paraqitja e kërkesës së tyre.

9. Informacioni kërkohet dhe u jepet personave të autorizuar nga titullarët e shërbimeve dhe njësisive të përmendura në pikën 8 të këtij neni, në një formë të verifikueshme. Mënyrat konkrete të kërimit dhe dhënies së informacionit do të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Kërkesat dhe informacionet trajtohen në përputhje me legjislacionin për informacionin e klasifikuar nga shërbimet dhe njësitë e përmendura në pikën 8 të këtij neni dhe sipërmarrësit e rrjeteve e shërbimeve të komunikimeve publike.”

Neni 4

Në nenin 117 bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 4 ndryshon me këtë përmbajtje:

“4. Fondi i shpenzimeve i mbetur si tepricë në fund të vitit buxhetor kalon në buxhetin e vitit pasardhës të AKEP që miratohet nga Këshilli i Ministrave, dhe i zbritet proporcionalisht sipërmarrësve nga pagesat që do të kryejnë për AKEP-in për vitin në vijim.”

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 më këtë përmbajtje:

“5. Fondi i padisbursuar i një prokurimi të nisur por të papërfunduar brenda vitit kalendarik, mbetet në buxhetin e AKEP për t’iu paguar furnizuesit vitin pasardhës sipas kushteve të pagesës së përcaktuar në kontratën e prokurimit të lidhur mes palëve”.

Neni 5

Dispozita kalimtare

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 9, të nenit 101 të këtij ligji.
2. Detyrimi sipas pikës 3, të nenit 89 të këtij ligji, për të dhënat e vendndodhjes të thirrësit të numrit të emergjencave zbatohet 6 muaj pas hyrjes në fuqi të tij.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ilir META